



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

---

*Raport Inspektimi Nr: 3/2013*

**VLERËSIMI I PËRFORMANCËS,  
GADISHMËRISË, TRAJNIMEVE DHE  
KUSHTEVE TË PUNËS NË NJSI-së**



**(Qërshor 2013)**

## SHKURTESAT

<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>
<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>PK -së</b>	<b>Policia e Kosovës</b>
<b>DPP</b>	<b>Drejtoria e Përgjthshme e Policisë</b>
<b>DNJS</b>	<b>Drejtoria e Njësive Speciale</b>
<b>NJSI</b>	<b>Njësia Speciale Intervenuse</b>
<b>NJSO</b>	<b>Njësia Speciale Operative</b>
<b>IEDD</b>	<b>Njësia për Trajtimin e Meterieve Eksploduese</b>
<b>GAKS</b>	<b>Grupi Avancues Kundër Snajperist</b>
<b>NJMA</b>	<b>Njësia e Mbrojtjes së Afërt</b>
<b>DSHSH</b>	<b>Drejtoria Shërbimeve Shëndetsore</b>
<b>IKSHPK</b>	<b>Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës</b>
<b>DSOP</b>	<b>Drejtoria për Sigurimin e Objekteve dhe Personaliteteve</b>

# P Ë R M B A J T J A

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## 2. HYRJE

## 3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI

*3.1 Vlerësimi i performancës së NJSI-së;*

*3.2 Vlerësimi i gatishmërisë reaguese të NJSI-së;*

*3.3 Vlerësimi i trajnimeve për NJSI-në;*

*3.4 Vlerësimi i kushteve të punës për NJSI-në;*

## 4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

*4.1 Përfundimi*

*4.2 Rekomandimet*

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1 dhe 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm nga data 11 qershor deri me 01 korrik 2013 Njesisë Speciale Intervenuese të PK-së.

1.2. Ky inspektim është përqendruar në vlerësimin e performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI-së duke u fokusuar në këto objektiva: Vlerësimi i performancës së NJSI-së; Vlerësimi i gadishmërisë reaguese të NJSI-së; Vlerësimi i trajnimeve për NJSI-në dhe Vlerësimi i kushteve të punës për NJSI-në.

1.3. Për kryerjen e operacioneve me rrezikshmëri të lartë/ ekstreme dhe zgjidhjen e situatave të cilat nuk mund të përballohen me shërbimet e tjera të PK-së, në kuadër të PK-së, si strukturë e veqante operationale funksionon NJSI. NJSI është njësi elite e PK-së, posaçërisht e trajnuar, e përgatitur dhe e pajisur me pajisje, uniformë përkatëse të veçantë, mjete dhe armë speciale.

1.4. Gjatë këtij inspektimi është gjetur se, Struktura Organizative e datës 20/05/2012 e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës që parasheh riorganizimin e të gjitha njësive të PK-së, ende nuk është funksionalizuar në NJSI edhe pse është një vit nga aprovimi i kësaj strukture. Mos funksionalizimi i strukturës së re për NJSI-në theksohet në mungesën e personelit policor në përgjithësi. Sipas kësaj strukture numri i personelit të NJSI duhet të jetë 51 staf i uniformuar plus 2 staf civil gjithsej 53 zyrtar dhe duhet të jetë e organizuar në tri ekipe taktike, plus një ekip avancues kundër snajper (GAKS). Po ashtu kjo njësi në bazë të strukturës në fjalë duhej të udhëhiqej nga zyrtari policor me gradën e kapitenit, ndërsa shefi i operativës të ketë gradën Togerit, si dhe ekipet të udhëhiqen nga zyrtarë policor me gradën e rreshterit. Në kohën e inspektimit NJSI numëronte 42 zyrtar prej tyre, një (1) toger (udhëheqës i NJSI), një (1) rreshter (shef i operativës), tridhjet e nëntë (39) operator dhe një (1) staf civil, pra ky numër dhe struktura udhëheqëse e NJSI nuk është në harmoni me strukturën organizative të datës 20/05/2012.

1.5. Gjatë këtij inspektimi është konfirmuar se NJSI ka plane për aktivitetet trajnuese për vitin 2012 dhe 2013, në të cilat janë paraparë trajnime: Ushtrime Fizike(UF), Taktika Mbrojtëse (UTM), Gjuajtje me Armë në Poligon (GJP), Ushtrime Taktike konform detyrave të NJSI etj. Aktivitetet trajnuese të NJSI-së, janë të bazuara në Planin e Standardizuar të Trajnimeve për Njësi Speciale, i aprovuar nga Drejtori i Njësive Speciale. Këto trajnime kanë për qëllim mirëmbajtjen e shkathtësive fizike dhe ato taktike të pjestarëve të NJSI-së. Për ngritjen të profesionalizmit dhe përfitimit të njohurive pjestarët e NJSI-së për fushat si: ekspert për hyrje me eksploziv, operacionet antiterror, lirim të pengjeve nga aeroplanet, trenat, zhytjes, skijim leshim nga helikopteret, parashutizëm, vëzhgim dhe kundërvëzhgim, trajnime komando etj, NJSI në bashmepunim me Njësi Special Turk (Ozel Harekat) të shtetit Turk për vitin 2012 ka realizuar 3 trajnime brenda vendit dhe një trajnim jashtë vendit në Turqi. Kurse gjatë gjashtëmujorit të parë 2013 janë realizuar 6 trajnime brenda vendit dhe 2 trajnime në Njësitin Special Turk (Ozel Harekat) në Turqi.

1.6. Përpos këtyre aktivitetëve trajnuese, NJSI ka realizuar edhe aktivitete operationale për vitin 2012 dhe gjashtë mujorin e parë 2013 si në vijim: gjatë vitit 2012: persona të arrestuar 7; armë të konfiskuara 5; plane operative 4; objekte të kontrolluara 5; përcjellje të aseteve më vlerë 33; Operacione Speciale 10; Përcjellje e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë 43. Ndërsa

gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2013, NJSI ka realizuar: 1 automjet të konfiskuar; persona të arrestuar 2; 5 objekte të kontrolluara; Percjellje të aseteve më vlerë 12; Operacione speciale 10; gjendje gadishmerie 3; gjuajtje me 5.56 mm (416-G-36) 1; gjuajtje me 9 mm (Glock dhe MP 5) 11; gjuajtje me 7.62, 39-AK-47 3; gjuajtje me 7, 62x51 snajper 2.

1.7. IPK-ja, në bazë të dokumentacionit të analizuar për aktivitetet e operacioneve dhe aktiviteteve trajnuese të NJSI-së të vitit 2012 dhe gjashtëmujorin e parë 2013 vlerëson se angazhimet e kësaj njësie në lidhje me keto aktivitete ka treguar një performancë të mirë dhe inkurajon në ngritjen më tutjeshme të performancës së përgjithshme në NJSI.

1.8. Gjatë këtij inspektimi IPK-ja ka gjetur se NJSI-ja punon në dy ndërrime. Ndërrimi i parë fillon nga ora 08:00 e deri në 16:00, ndërsa ndërrimi i dytë nga ora 14:00 deri 22:00. Prej orës 14:00 e deri 16:00 të dy ndërrimet janë së bashku në bazë. Ndërsa periudha nga 22:00 e deri në orën 08:00 të mëngjesit e gjithë NJSI-ja është në thirrje. Në bazë të intervistave me komandantin dhe operatorët e NJSI-së, inspektorët e IPK-së mësuan së në lidhje me gadishmerinë e kësaj njësie për reagim nuk ka diçka të shkruar për sa kohë duhet njësia të jetë e gatshme për reagim gjatë orarit të rregullt të punës dhe kohës kur kjo njësi është në thirrje. Për operacione të planifikuara nuk ka problem që njësia të jetë në vendin e caktuar por problem paraqet ndonjë operacion i paplanifikuar dhe njësia është në kohën e ashtuquajtur "në thirrje", kur operatorët e njesisë duhet të mblidhen në bazë, nga vendbanimet e shpërndara nëpër të gjitha rajonet e Kosovës.

1.9. Gjatë këtij inspektimi IPK-ja ka gjetur se personeli i NJSI-së, ka shprehur shqetësim lidhur me selektimin e personelit të njesisë për vijimin e trajnimit jashtë vendit i cili ishte mbajtur nga data 03-28 Qershor 2013 në Turqi. Sipas tyre në këtë trajnim është dashtë të jenë të perfshirë vetëm pjesëtarët e NJSI-së, kurse në këtë trajnim janë dërguar edhe zyrtar policor nga njësiti tjera speciale. Pas analizimit të programit trajnus të ofruar nga shteti i Turqisë dhe ftesës së bërë DNJS nga Departamenti i Trajnimeve, IPK-ja konstaton se ky trajnim ishte një vazhdimësi e programeve të trajnimeve të organizuar nga Njësi Special Turk (Ozel Harekat) me NJSI dhe ky trajnim ka qenë i përgatitur për pjesëtarët e NJSI-së. Po ashtu IPK-ja konstaton se DNJS nuk ju ka përmbajtë ftesës së Departamentit të Trajnimeve për caktimin e 20 pjesëtarëve të NJSI për trajnim në Turqi dhe nga kjo njësi janë dërguar në trajnim vetëm 10 pjesëtar policor kurse 10 pjesëtarë policor të tjerë janë të njësive tjera speciale të PK-së.

1.10. Gjatë inspektimit të kushteve higjienike/pastërtisë dhe ushqimit në kampin "Vrella" Sllatinë, IPK-ja konstatoi mungesë të kushteve higjienike/pastërtisë, infrastruktura e vjetruar të banjave, WC-ve si dhe çarçafët dhe batanijet që përdoren në dhomën e pushimit të cilat janë të vjetruara dhe të pa pastra, ato pastohen vetëm nga vet operatorët e NJSI, me vetiniciativ i dërgojnë në shtëpi të tyre për pastrim. Po ashtu IPK-ja konstaton se ushqimi i përgatitur nga SH.P.K BENI - DONA, nuk është i kualitetit të knaqshëm dhe nuk përmbush normën kalorike të nevojshme për NJSI.

1.11. Në bazë të PSO së NJSI, secili pjesëtarë i NJSI-së para se të filloj me testimet (testi operacional për NJSI) duhet ti nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm shëndetësor, ky kontroll do të kryhet në kordinim me Shërbimet Shëndetësore të PK-së, në sajë të kriterëve që përcaktojnë ata.<sup>1</sup> Nga egzaminimi mjekësor i fundit, sipas dokumentacionit të prezantuar nga DSHSH/DPP, 25 pjesëtar nga numri total 40 i pjesëtarëve të NJSI të ekzaminuar janë të diagnostifikuar me *Helicobakter Pylori* pozitiv/aktiv dhe shumica me *Pëngesat*

<sup>1</sup> Procedurat Standarde të Operimit të NJSI-së/ 16.1 Kriteret e Testit Operacional;

*Gastroenterologjike*<sup>2</sup>. Përkundër Diagnostifikimit të pjestarëve të NJSI, sipas rekomandimit të DSHSH/DPP këta pjestar të NJSI janë të aftë për punë në NJSI por ata duhet kryer terapitë përcjellëse.

1.12. Pas ngritjes së shqetësimeve dhe polemikave që ishin shkaktuar brenda NJSI-së lidhur me shëndetin e operatoreve, DSHSH/DPP në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik ka vizituar Kampin "Vrella" me qëllim vlerësimi të Standardeve të Higjienës. Sipas Konkluzionit të raportit të IKSHPK-së, Standardet e Higjienës paraqesin rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e të punësuarve në Kampin "Vrella"<sup>3</sup>. Sipas DSHSH/DPP si burim i infeksionit ishte: 1) Ushqimi dhe uji i pa kontrolluar është burimi i infeksionit; dhe 2) Përqindja e infektimit është thellësisht në funksion të kushteve të higjienës.

1.13. Në bazë të PSO së NJSI, në pikën 10 të rubrika Vërejtje shkruan: NJSI-së sipas kërkesës duhet të furnizohen me rroba civile dhe sportive një herë në vit dhe këto duhet të paguhen nga buxheti i PK-së i cili duhet të ndahet enkas gjatë çdo viti vetëm për NJSI. Gjatë inspektimit në NJSI, inspektorët e IPK-së nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët e NJSI mësuan se zyrtarët e NJSI nuk janë furnizuar me rroba civile dhe sportive dy apo tri vitet e fundit. Sipas menaxherëve të Drejtorisë së Njësive të Specializuara mos furnizimi i pjestarëve të NJSI me këto pajisje është përshkaqe buxhetore. IPK-ja konstaton se nuk respektohet PSO e NJSI në lidhje me furnizim me rroba civile dhe sportive.

1.14. Gjatë inspektimit nga ekipa e inspektorëve është bërë edhe vrojtimi i kampit dhe hapësirës rreth tij. Kampi "Vrella" Sllatinë sigurohet 24 orë nga 6 zyrtarë të Drejtorisë për Sigurimin e Objekteve dhe Personaliteteve, të pajisur me armë brezi dhe të gjata. Hapësira ku është vendosur kampi përfshinë një territor të madh, dhe rrethojat rreth perimetrit të bazës janë të dëmtuara në disa vende, dhe për këtë menaxhmenti kompetent duhet të bejë përpjekjet e nevojshme me qëllim të ngritjes dhe përmirësimit të nivelit të sigurisë në Kampin "Vrella", pasi që ky kamp me njësitë e vendosura aty është i një rëndësie të veçantë për vendin. Objekti i Kampit "Vrella" Sllatinë në kohën e inspektimit nuk posedonte shkallë/dalje emergjente, poashtu në kohën e inspektimit menaxherët e kampit nuk kanë prezantuar Plan Evakuimit nga kampi në raste emergjente. Sipas komandantit të NJSI-se kjo njësi duhet që edhe me lokacion të jetë e ndare nga njësitë tjera të specializuara për shkak të ndjeshmërisë së operacioneve dhe aktiviteteteve tjera që ka në mandat kjo njësi.

---

<sup>2</sup> Raporti dërguar më poste elektronike nga DSHSH/DPP, Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së (Sent: Wed. 5/29/2013 10:49 AM);

<sup>3</sup> Konkluzion i IKSHPK dërguar më poste elektronike nga DSHSH/DPP, Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së (Sent: Wed. 5/29/2013 10:49 AM);

## 2. HYRJE

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm nga data 11 qershor deri me 01 korrik 2013 Njesisë Speciale Intervenuese në PK-së.

2.2. Qëllim i inspektimi është vlerësimi i kryerjes së detyrave nga personeli kompetent i angazhuar në NJSI, menaxhimi i NJSI në përputhje me legjislacionin në fuqi, të jepet një vlerësim objektiv mbi respektimin e dispozitave ligjore, procedurave dhe rregullave, përmbushjen e objektivave kundrejt të priturave si dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e kryerjes së detyrave dhe menaxhimin e NJSI-së.

2.3. Objektivi që synon të arrij inspektimi ishte:

- Vlerësimi i performancës së NJSI-së;
- Vlerësimi i gadishmërisë reaguese të NJSI-së;
- Vlerësimi i trajnimeve për NJSI-në; dhe
- Vlerësimi i kushteve të punës për NJSI-në;

2.4. Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Ligjin e Policisë së Kosovës;
- Doracakun e Perimeve dhe Procedurave të PK-së;
- Procedura Standarde e Operimit NJSI-së,

2.5. Rëndësia e inspektimit qëndron në atë se veprimtaria e NJSI-së është një ndër fushat më të ndjeshme në punën policore ku nevojitet një përgatitje psikike/fizike, e nivelit më të lartë dhe pajisje adekuate për të siguruar performancë më të mirë në NJSI, përmes së cilës mund të sigurohet një besueshmëri dhe respekt nga ana e qytetarëve të Kosovës ndaj PK-së.

2.6. Gjatë inspektimit në NJSI, IPK-ja, ka aplikuar metodat e punës inspektuese, duke zhvilluar intervista, marrë dokumentacionin relevant në bazë të cilit punon NJSI, DNJS të PK-së, Departamenti i Trajnimeve të PK-së dhe DSHSH e PK-së.

2.7. Gjatë inspektimit në NJSI, personeli i IPK-së ka intervistuar zyrtarët si në vijim:

- Drejtorin e Njësive Speciale;
- Komandantin e NJSI-së;
- Mbikëqyrësit e Ekipeve Taktike
- Mbikëqyrësin për Resurse në NJSI;
- Zyrtarin Përgjegjës në Dhomën e Armëve në NJSI; dhe
- Oficer policor që operojnë në NJSI;

### 3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

#### 3.1 . Vlerësimi i Performancës së NJSI-së

3.1.1. Për kryerjen e operacioneve të sigurisë në raste të veçanta dhe zgjidhjen e situatave të cilat nuk mund të përballohen me shërbimet e tjera të PK-së, në kuadër të PK-së, si strukturë operacionale, vepron NJSI e cila angazhohet në rastet kur përmbushja e detyrave zyrtare të mbrojtjes së jetës dhe pasurisë, paraqet rrezikshmëri tejet të lartë për rendin dhe sigurinë në përgjithësi dhe për pjesëtarët e PK-së, në veçanti. NJSI, është njësi elite e PK-së, posaçërisht e trajnuar, e përgatitur dhe e pajisur me pajisje, uniformë përkatëse të veçantë, mjete dhe armë speciale.

3.1.2. Pjesëtarëve të NJSI-së u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale. NJSI, ka PSO, ku më hollësisht përcaktohen: organizimi, seleksionimi, strukturën, pajisjet dhe mjetet teknike, automjetet, rregullat e angazhimit, trajnimi dhe procedurat tjera të punës që NJSI zbaton në kryerjen e detyrave zyrtare<sup>4</sup>. NJSI, vepron si njësi permanente operacionale e formuar dhe me autorizim veprimi operacional në tërë territorin e Republikës së Kosovës. NJSI, është e vendosur/stacionuar në Kampin “Vrella” Sllatinë në objekt të përbashkët me njësitë tjera të specializuara si: NJSO, IEDD, po ashtu në këtë kamp ushtrimet/trajnimet i mban edhe Njësia K9.

3.1.3. Gjatë këtij inspektimi është gjetur se, Struktura Organizative e datës 20/05/2012 e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës që parasheh riorganizimin e të gjitha njësive të PK-së, ende nuk është funksionalizuar në NJSI edhe pse është një vit nga aprovimi i kësaj strukture. Mos funksionalizimi i strukturës së re për NJSI-në theksohet në mungesën e personelit policor në përgjithësi. Sipas kësaj strukture numri i personelit të NJSI duhet të jetë 51 staf i uniformuar plus 2 staf civil gjithsej 53 zyrtar dhe duhet të jetë e organizuar në tri ekipe taktike, plus një ekip avancues kundër snajper (GAKS). Po ashtu kjo njësi në bazë të strukturës në fjalë duhej të udhëhiqej nga zyrtari policor me gradën e kapitenit, ndërsa shefi i operativës të ketë gradën Togerit, si dhe ekipet të udhëhiqen nga zyrtarë policor me gradën e rreshterit. Në kohën e inspektimit NJSI numëronte 42 zyrtar prej tyre, një (1) toger (udhëheqës i NJSI), një (1) rreshter (shef i operativës), një (1) staf civil dhe tridhjet e nëntë (39) operator, ky numër dhe strukturë udhëheqëse e NJSI nuk është harmoni me strukturën organizative në fuqi (20/05/2012).

#### **Rekomandimi nr. 1**

IPK-ja, Rekomandon: Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, implementimin e Strukturës Organizative të datës 20/05/2012, e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, në lidhje me personelin e përgjithshëm, vendosjen e personave me grada nëpër pozita në harmoni me strukturën në NJSI-në.

3.1.4. Gjatë këtij inspektimi është konfirmuar se NJSI ka plane për aktivitetet trajnuese për vitin 2012 dhe 2013, në të cilat janë paraparë trajnime: Ushtrime Fizike(UF), Taktika Mbrojtëse (UTM), Gjuajtje me Armë në Poligon (GJP), Ushtrime Taktike konform detyrave të NJSI etj. Aktivitetet trajnuese të NJSI-së, janë të bazuara në Planin e Standardizuar të Trajnimeve për Njësi Speciale, i aprovuar nga Drejtori i Njësive Speciale. Këto trajnime kanë për qëllim mirëmbajtjen e shkathtësive fizike dhe ato taktike të pjestarëve të NJSI-së. Për ngritjen të

<sup>4</sup> Doracaku i Parimeve dhe Procedurave- dhjetor 2009, parimi 4.55



profesionalizmit dhe përfitimit të njohurive pjestarët e NJSI-së për fushat si: ekspert për hyrje me eksploziv, operacionet antiterror, lirim dhe pengjeve nga aeroplanet, trenat, zhytjës, skijim leshim nga helikopteret, parashutizëm, vëzhgim dhe kundërvëzhgim, trajnime komando etj, NJSI në bashmepunim me Njësitë Special Turk (Ozel Harekat) të shtetit Turk për vitin 2012 ka realizuar 3 trajnime brenda vendit dhe një trajnim jashtë vendit në Turqi. Kurse gjatë gjashtëmujorit të parë 2013 janë realizuar 6 trajnime brenda vendit dhe 2 trajnime në Njësitin Special Turk (Ozel Harekat) në Turqi.

3.1.5. Përpos këtyre aktiviteteve trajnuese, NJSI ka realizuar edhe aktivitete operacionale për vitin 2012 dhe 2013 si në vijim: gjatë vitit 2012: persona të arrestuar 7; armë të konfiskuara 5; plane operative 4; objekte të kontrolluara 5; përcjellje të aseteve më vlerë 33; Operacione Speciale 10; Përcjellje të burgosurve me rrezikshmëri të lartë 43. Ndërsa në vitin 2013, NJSI ka realizuar: 1 automjet të konfiskuar; persona të arrestuar 2; 5 objekte të kontrolluara; Përcjellje të aseteve më vlerë 12; Operacione speciale 10; gjendje gadishmerie 3; gjuajtje me 5.56 mm (416-G-36) 1; gjuajtje me 9 mm (Glock dhe MP 5) 11; gjuajtje me 7.62, 39-AK-47 3; gjuajtje me 7, 62x51 snajper 2.<sup>5</sup>

3.1.6. IPK-ja, në bazë të dokumentacionit të analizuar për aktivitetet trajnuese dhe operacionale të NJSI-së për vitin 2012 dhe gjashtëmujorin e parë 2013 vlerëson se angazhimet e kësaj njësie në lidhje me aktivitetet e zhvilluara ka treguar një performancë të mirë dhe inkurajon në ngritjen e mëtutjeshme të performancës së përgjithshme në NJSI.

#### **Rekomandimi nr. 2**

IPK-ja, rekomandon: komandanti dhe operatorët e NJSI, të angazhohen më tepër me qëllim të ngritjes së përqindjes së realizueshmërisë të planit për aktiviteteve trajnuese në NJSI, për ngritjen e performancës dhe gatishmerisë së kësaj njësie.

### **3.2. Vlerësimi i gadishmërisë reaguese të NJSI-së**

3.2.1 Duke marr parasysh se kjo njësi është në gadishmeri 24 orë në përgjigje urgjente ndaj kërcnimeve apo akteve të dhunës që rrezikojnë apo çrregullojnë sigurinë e përgjithshme publike. Për të kryer misionin e vet, NJSI-ja mund të angazhohet në operacione të përbashkëta me njesitë e tjera të Policisë së Kosovës. Për të kryer këto detyra me sukses NJSI-ja si njësi elite e PK-së ka trajnime, përgatitje dhe pajisje për të operuar në operacionet e rrezikshmërisë së lartë apo ekstreme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

3.2.2. NJSI-ja, punon në dy ndërrime. Ndërrimi i parë fillon nga ora 08:00 e deri në 16:00, ndërsa ndërrimi i dytë nga ora 14:00 deri 22:00. Prej orës 14:00 e deri 16:00 të dy ndërrimet janë së bashku në bazë. Ndërsa periudha nga 22:00 e deri në orën 08:00 të mëngjesit e gjithë NJSI-ja është në thirrje.

3.2.3. Në bazë të intervistave me komandantin dhe operatorët e NJSI-së, inspektorët e IPK-së mësuan së në lidhje me gadishmerinë e kësaj njësie për reagim nuk ka diçka të shkruar për sa kohë duhet njësi të jetë e gatshme për reagim gjatë orarit të rregullt të punës dhe kohës kur kjo njësi është në thirrje. Sipas komandantit të njësisë dhe operatorëve të intervistuar, për operacione të planifikuara nuk ka problem që njësi për një kohë prej 30 minutash të jetë në vendin e caktuar por problem paraqet ndonjë operacion i paplanifikuar dhe njësi është në kohën e ashtuquajtur "në thirrje", kur operatorët e njësisë duhet të mblidhen në bazë, nga

<sup>5</sup> Raporti vjetor 012 dhe gjashtëmujori i parë 2013

vendbanimet e shpërndara nëpër të gjitha rajonet e Kosovës gjatë kësaj kohe NJSI mund të reagoj në çdo pjesë të Kosovës nga moment i marrjas së urdhërit/thirrjes e deri në vendin e ngjarjes për afersisht brenda intervalit kohor 2 orësh.

#### **Rekomandimi nr. 3**

IPK-ja rekomandon: Komandantit të njësisë që në bazë të analizimit të faktorëve dhe testimit të nxjerrë në formë të shkruar parametrat që përcaktojnë kohën e shpejtësisë së mobilizimit dhe reagimit të kësaj njësie në përgjigje të rasteve dhe operacioneve policore duke e konsideruar seriozisht që kjo njësi të jetë në detyrë 24 orë, pra të punoj në tre ndrrime.

3.2.4. Duke vepruar në harmoni me Urdhëresën nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse për Zvoglimin e Shpenzimeve në derivate për 40%, Drejtoria e Njesive të Specializuara ka vendos që veturat në thirrje të parkohen në Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe ka bërë reduktimin e numrit të veturave në thirrje (nga 12 vetura në thirrje tash janë 8 plus 1 për komandantin e njësisë). Sipas operatorëve të njësisë zvoglimi i numrit të veturave në thirrje dhe parkimi i tyre në DRP paraqet një problem si për sigurinë e operatorëve po ashtu edhe për kohën e mobilizimit për veprim të NJSI-së. Pasi që operatorët e NJSI-së duhet të pari të shkojnë deri në stacion për të marrë veturën në thirrje e pastaj të bëjnë grumbullimin e kolegeve të shpërndarë nëpër qytetet/fshatrat e rajoneve nga vijnë. IPK-ja inkurajon PK-së në politikën e uljes së shpenzimeve në derivate, por kur kihet parasysh niveli i rrezikshmërisë që bartin me vete pjestarët e kësaj njësie sepse veprojnë në operacionet speciale të vlerësuar me rrezik të lartë/ekstrem me autorizim veprimi operacional në tërë territorin e Republikës së Kosovës. IPK-ja mendon se Menaxhmenti i lartë i PK-së duhet t'u dalë në përkrahje NJSI sa i përket numrit të veturave në thirrje ose të aplikoj sistemin e punës në tre ndrrime.

#### **Rekomandimi nr. 4**

IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të DNJS të PK-së t'u dalë në përkrahje operatorëve të NJSI-së të gjitha rajoneve nga vijnë në lidhje me transportin, të shtohet numri i veturave në thirrje me qëllim të ngritjes së performancës, sigurisë, motivimit në NJSI.

3.2.5. Inspektorët e IPK-së gjatë inspektimit në NJSI, nga komandanti dhe operatorët e njësisë në pyetjen për raportet kolegjiale në NJSI morën përgjigjen se raportet në njësi janë të shkëlqyera, por personeli i NJSI-së ndihet i anashkaluar nga ana e menaxhmentit të lartë të Drejtorisë, Divizionit e deri tek Drejtoria e Përgjithshme e PK-së, pasi që një periudhë të gjatë kohore NJSI-ja, nuk ishte vizituar asnjëherë nga menaxhmenti i lartpërmendur. Ky anashkalim i strukturave udhëheqëse të PK-së, karshi NJSI-së, sipas operatoreve të sajë ndikon negativisht në ngritjen e motivit dhe moralit për punë.

### **3.3. Vlerësimi i trajnimeve për NJSI**

3.3.1. PSO e NJSI-së, në pikën 14 paraqet Strukturën e Përgjithshme të Trajnimit në NJSI. Në bazë të kësaj pike përcaktohet se, NJSI kur të shihet e nevojshme/arsyeshme mund të përfshihet në trajnime apo operacione të përbashkëta me njësitë tjera të specializuara në PK-së siç janë: Njësia K-9, IEDD, NJSO, NJMA dhe organizata tjera të sigurisë: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Forcat Speciale të EULEX-it, KFOR-it.

3.3.2. Në brendësi të NJSI-së trajnimi është i ndarë në katër principe: Trajnimi Permanent; Trajnim direkt apo i brendshëm; Trajnim personal dhe Trajnimi progresiv. Po ashtu në NJSI, trajnimet janë të ndara në tri nivele: Niveli i Ekipit; Niveli i Njësitit; dhe Trajnimet Speciale<sup>6</sup>.

3.3.3. Inspektorët e IPK-së, nga vizita dhe intervistat e zhvilluar në NJSI, kanë nxjerr si përfundim se principet dhe nivelet e trajnimit, realizohen me një përkushtim të shkëlqyer nga ana e stafit të NJSI dhe këto trajnime janë të nivelit të lartë.

3.3.4. Selektimi dhe caktimi i operuesve në trajnime brenda dhe jashtë vendit në NJSI bëhet në bazë të nevojave dhe mundësive operative por si kushte tjera bazë mund të jenë edhe: profili i trajnimit; disiplina e operuesit; përgatitja fizike apo rezultati më i mirë në testimet operative si dhe angazhimi apo përkushtimi në punë<sup>7</sup>.

3.3.5. Nga intervistat me komandantin e njësisë dhe operatorët, inspektorët e IPK-së nuk hasen në ndonjë vrejte në mënyrën e selektimit të operuesve për trajnime, që kryhet brenda njësisë por shprehën një shqetësim me listën e zyrtarëve policor të dërguar në një trajnim jashtë vendi në Turqi, të hartuar në Divizionin e Njësive të Specializuara. Sipas tyre në këtë trajnim është dashtë të jenë vetëm pjesëtarët e NJSI kurse në këtë trajnim janë dërguar edhe zyrtar policor të njësive tjera.

3.3.6. Duke pas për bazë shqetësimin e shprehur në NJSI, inspektorët e IPK-së, kanë konsultuar parimin P-8.16 "Trajnimet e punonjësve të Policisë brenda dhe jashtë vendit", të datës 14 tetor 2011. Parim i aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

3.3.7. Parimi P-8.16, në mënyrë të qartë përcakton detyrat dhe përgjegjësitë nga kjo fushë. Për inspektorët e IPK-së, duke pas parasysh shqetësimin e NJSI-së, u konsultuan dy pikat nga ky parim dhe atë pika 3 dhe 4. Pika 3 citojmë: Departamenti i Trajnimeve do t'i përcakton kriteret për pjesëmarrje në trajnim dhe me shkrim apo përmes postës elektronike do të kërkojë nominimin e zyrtarëve për trajnim nga departamentet apo drejtoritë përkatëse që përgjigjen trajnimit përkatës. Pika 4 citojmë: Drejtoria për Mbështetje të trajnimeve do ta përgatisë listën e zyrtarëve për trajnim jashtë vendit, të nominuar nga departamentet apo drejtoritë përkatëse dhe përmes zinxhirit komandues listat dërgohen tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë për aprovim<sup>8</sup>.

3.3.8. Në Departamentin e Trajnimeve, inspektorët kanë siguruar kërkesën e datës 30 prill 2013, dërguar Divizionit të Njësive të Specializuara, për nominim të zyrtarëve policor për trajnim në Turqi, citojmë: "Në përmbajtjen e trajnimit për operacione të specializuara do të jenë temat si në vijim: Operacionet në terren, teknikat e hyrjes në toka, teknikat e alpinizmit dhe zbritjes, analizimi, hartografi, krijimi i ekipeve, prita dhe vëzhgim. Ky trajnim është i përgatitur për zyrtarët e FIT-it nga Divizioni i Njësive Speciale. Divizioni i Trajnimeve kërkon nominimin e 19 zyrtarëve që të jenë pjesëmarrës në këtë trajnim. Nominimet duhet të dërgohen më se voni deri më datë 02.05.2013 në ora 12:00" përfundim i citatit<sup>9</sup>.

3.3.9. Në interesimin e inspektorëve të IPK-së në Divizionin e Njësive të Specializuara për kërkesën e datës 30 prill 2013 të Departamentit të Trajnimeve. U.D. i Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, inspektorëve u prezanton kërkesën për aprovim të listës së zyrtarëve

---

<sup>6</sup> NJSI/PSO/001/11

<sup>7</sup> NJSI/PSO/001/11/14.1c

<sup>8</sup> Doracaku i parmeve dhe Procedurave të PK-së/P-8.16 datë 14 tetor 2011;

<sup>9</sup> Emaili nga N/kol. Zylfije Krasniqi tek N/kol. Neshat Flugaj Tuesdaz, Aprill 30, 2013 2:37 PM

policor për trajnim në Turqi i cili do të mbahej nga data 03-28 Qershor 2013, drejtuar nga DNJS përmes postës elektronike Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Kjo listë nuk përbehej vetëm nga pjestarët e NJSI-së por është e kombinuar edhe me pjestar të njësive tjera të specializuara të PK-së. Në përberje të kësaj liste prej 19 zyrtarëve policor, përfshihen 10 pjesëtar të NJSI-së, 4 pjesëtar të NJSO-së, 4 pjesëtar të NJMA-së dhe 1 pjesëtar i IEDD-së.

3.3.10. Bazuar sipas parimit P-8.16, listen e nominuar të zyrtarëve policor për trajnim në Turqi, DNJS- duhej t'ia dërgonte Departamentit të Trajnimeve dhe ky i fundit pas verifikimit të saj duhej përmes zingjirit komandues të dërgoj për aprovim te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. IPK-ja, konstaton se në rastin në fjalë, procedurat e parapara në P-8.16 nuk janë respektuar nga U.D i Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, duke anashkalur zingjirin e komunikimit zyrtar i cili listën e nominuar për trajnim nuk e dërgon në Departamentit të Trajnimeve por këtë listë e dërgon direkt te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë për aprovim e cila pas aprovimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dërgohet Departamentit të Trajnimeve.

#### **Rekomandimi nr. 5**

IPK-ja, rekomandon: U.D Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, në të ardhmën të veprimi në bazë të kërkesës së Departamentit të Trajnimeve dhe të aplikoj me përpikëri të plotë P-8.16. Listen e nominuar të zyrtarëve policor për trajnim jashtë vendi DNJS ta dërgoi te Departamenti i Trajnimeve për procedim të matutjeshëm.

3.3.11 Inspektorët e IPK-së, gjatë intervistave me Drejtorin e NJS dhe Komandantin e NJSI-së mësuan se kjo listë për trajnim në Turqi në fillim ka qenë e përpiluar vetëm me 20 pjestar të NJSI (grupi Alfa).<sup>10</sup> por më vonë kjo listë është ndryshuar me kërkesën e stafit të lartë të Divizionit të Njësive të Specializuara, nga NJSI është kërkuar të nominoj 10 pjestarë të saj për këtë trajnim. Inspektorët e IPK-së nuk arritën të sigurojnë diçka të shkruar në lidhje me këtë kërkesë nga Divizioni i Njësive të Specializuara, Drejtoria e NJS dhe Komandanti e NJSI-së.

3.3.12 Në bazë të raportit të datës 01.07.2013 të Udhëheqesit të grupit që ka vijuar trajnimin në Turqi në Komandën e Njësimit Special Turk (Ozel Harekat), mësohet se trajnimi i oficerëve të PK-së ka vajtur mirë me prejashtim të asaj që në fillim të programit trajnues instruktoret turq për shkaqe të sigurisë dhe aftësive, në poligon kanë bërë ndarjen e policëve në dy grupe ku në një grup ishin 10 polic nga NJSI dhe në grupin tjetër zyrtarët policor tjerë nga NJMO, NJMA dhe IEDD. Mirëpo pas performancës së treguar të zyrtarëve policor nga NJSO, NJMA dhe IEDD nuk ishte parë me e nevojshme të behet ndarja në grupe të veçanta.<sup>11</sup> IPK-ja mendon se përzjerja e pjestarëve policor nga njësitë tjera për trajnimin ka pasur efekte negative i cili në njërin anë ka lëshuar mundësin e shfrytëzimit racional të benefitit që mund të nxjerrë nga trajnimi duke e zvogëluar numrin e pjestarëve të NJSI-së dhe në anën tjetër ky veprim ka treguar një jo seriozitet nga ana e PK-së karshi donatorit të këtij trajnimi, Njësimit Special Turk (Ozel Harekat).

3.3.13. Pas analizimit të programit trajnus të planifikuar nga Departamenti i Trajnimeve, IPK vlerëson se programi, temat e këtij trajnimi dhe Njesia nikoqire që mban këtë program trajnues më se tepërmi i përgjigjej nevojave dhe detyrave që ushtron NJSI e PK-së. Andaj me vendimin, që të reduktohet lista e vijuesve të trajnimit nga NJSI për tu plotësuar me vijues nga njësitë tjera, NJSI ishte dëmtuar pasi që ky trajnim ishte një vazhdimësi e programeve të trajnimeve të organizuar nga Njësiti Special Turk (Ozel Harekat) me NJSI.

<sup>10</sup> Propozimi për trajnim, Komunikimi zyrtar nga menaxheret e NJSI/ 2013-07-04 8:58 PD

<sup>11</sup> Raporti pas trajnimit në Turqi Nr. Ref. NJSI-2013

3.3.14 NJSI gjatë vitit 2012, ka realizuar 5 trajnime të llojeve të ndryshme që kanë të bëjnë me punët e NJSI-së. Nga ky numër, 4 trajnime janë realizuar në vend, me 59 pjesëmarrës, kurse 1 trajnim është mbajtur jashtë vendit (Turqi) me numër të pjesëmarrësve 24. Numri total e zyrtarëve të NJSI të përfshirë në trajnime si brenda vendit dhe jashtë për vitin 2012 arrin në 83. Kurse gjatë gjashtëmujorit të parë të 2013, NJSI ka realizuar 5 trajnime të ndryshme që kanë të bëjnë me punët e njësisë, nga këto trajnime brenda janë realizuar 3 trajnime me 5 pjesëmarrës, 2 trajnime janë mbajtur jashtë vendit (Turqi) me numër të pjesëmarrësve 16. Numri total e zyrtarëve të NJSI të përfshirë në trajnime si brenda vendit dhe jashtë për gjashtëmujorin e parë 2013 arrin në 21<sup>12</sup>.

#### 3.4. Vlerësimi i kushteve të punës

3.4.1. NJSI, është e vendosur në Kampin "Vrella" Sllatinë në objekt të përbashkët me njësitë tjera të specializuara si: NJSO, IEDD. Në këtë kamp ushtrimet/trajnimet i mban edhe njësi K9. Gjatë këtij inspektimi është vlerësuar edhe infrastruktura në Kampin "Vrella" si p.sh. salla e ushqimit, hapësira për aktivitete sportive, hyrje-daljen. Parkingun e veturave e përdorin edhe njësitë tjera të vendosura në këtë kamp, gjë e cila i shqetëson stafin i NJSI-së. Sipas zyrtarëve të NJSI-së prezenca dhe qëndrimi i përbashkët në një kamp me njësitë tjera paraqet rrezik në mbrojtjen e identitetit të operatorëve të njësisë, ushtrimeve taktike konformë detyrave dhe zbulimin e aktiviteteve/operacioneve të tyre. Nga intervista me komandantin e NJSI-së, inspektorët mësuan edhe për një rekomandim rreth zhvendosjes së NJSI në Kampin "Vrella", ku ai kërkon të rishikohet zhvendosja e NJSI për shkak të shqetësimeve të lartpërmendur nga operatorët dhe praktikave të vendeve: Shqipëri, Maqedoni, Mali Zi, Slloveni, Bullgari, ku këto njësi elite janë të vendosura ndaras<sup>13</sup>.

3.4.2. Hapësira në objekt ku janë të vendosur është e mjaftueshme, kanë: dhomën e qëndrimit ditor, dhomat e fjetjes me krevat, banjo, tush kabina, sallën e brifingut, armëtoren, armatim të mirë (kryesisht të prodhimit Gjerman, Hekler), vetura (me targa civile, të blinduara të cilat përdorën vetëm në operacionet e njësisë), poligonin për gjuajtje me armë, vende për ushtrime taktike konform detyrave.

3.4.3. Gjatë këtij inspektimi janë inspektuar edhe pajisjet e NJSI-së. IPK-ja ka vërtetuar se Jeleket antiplumb të cilët i shfrytëzojnë operatorët e kësaj njësie tash e një kohë të gjatë kishin afatin e skaduar të përdorimit. Menaxheret e kësaj njësie deklaruan se deri tek kjo gjendje ka ardhur për shkak të negjces së proceduarve të blerjes sipas kërkesave dhe specifikave që kanë kërkuar NJSI-ja. Por gjatë periudhës sa zgjati inspektimi nga IPK-ja, është bërë furnizimi me jelek antiplumb ku janë zëvendësuar jelekët e vjetër me afat të skaduar me Jelek antiplumb të ri sipas cilësisë së garantuar dhe specifikave për profilin e NJSI-së.

3.4.4. Mirëmbajtja brenda në objekt dhe jashtë objekti (pastërtia) është e nivelit të mirë, me përjashtim të banjave. Banjat, tush kabinat janë të rregulluara sipas sistemit të vjetër dhe kanë nevojë për renovime të mirëfillta me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të zyrtarëve të njësisë. Vlen të theksohet se gjatë inspektimit inspektorët e IPK-së hasën në një breng e cila i mundonte zyrtarët e njësisë, mos kujdesi i organizatës rreth furnizimit dhe pastërtisë së çerçafëve dhe batanijeve në dhomat e fjetjes që përdorin operatorët. Çarçafët dhe mbulojat ekzistuese ishin të vjetruara dhe operatorët me vet organizim i marrin dhe i pastrojnë në shtëpitë e tyre.

<sup>12</sup> Email 2013-06-20 10:42 PD

<sup>13</sup> Rekomandimi rreth zhvendosjes së NJSI në Kampin Vrella Nr. Ref. NJSI/2010 datë 15.06.2010;

3.4.5. PSO-ja e njësisë përcakton se, kjo njësi duhet të pajiset me pajisje të veçanta teknike dhe taktike, në mënyrë që të manovroj (veproj) në çfarëdo situata apo operacione që i ipen. Po ashtu në PSO në pikën 10 të rubrika Vërejtje shkruan: NJSI sipas kërkesës duhet të furnizohen me rroba civile dhe sportive një herë në vit dhe këto duhet të paguhen nga buxheti i PK-së i cili duhet të ndahet enkas gjatë çdo viti vetëm për NJSI. Gjatë inspektimit në NJSI, inspektorët e IPK-së mësuan se zyrtarët e NJSI nuk janë furnizuar me rroba civile dhe sportive dy apo tri vitet e fundit.

3.4.6 Bazuar në të dhenat e nxjerra nga intervistat me stafin dhe dokumentacionit të analizuar, NJSI nuk është furnizuar me pajisje sportive dhe rroba civile, me gjithë kërkesat e vazhdueshme nga NJSI drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara. Duke pas parasysh aktivitetet dhe operacionet që kryen NJSI si njësi elite, IPK-ja rekomandon, të respektohet PSO në lidhje me furnizimin e zyrtarëve të NJSI me rroba civile dhe sportive adekuate.

#### **Rekomandimi nr. 6**

IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara që të rivlerësoj lokacionin në të cilin gjendet NJSI duke marrë në konsiderat ruajtjen/fshehjen e identitetit të operatorve gjatë operacioneve të ndryshme që kryen NJSI, të kujdeset që paisjet që ka në përdorim kjo njësi të jenë e kualitetit më të lartë dhe në gjendjen më të mire si dhe në përrputhje me pikën 10 të PSO së NJSI, të bëjë me furnizimin me rroba civile dhe sportive, me qëllim të ruajtjes së shëndetit gjatë aktiviteteve fizike.

3.4.7. Gjatë këtij inspektimi është gjetur se organizata e PK-së, ka siguruar për pjesëtarët e Njësive Speciale të vendosura në Kampin “Vrella” ushqimin dhe atë një porcion për ndërrim (drekë/darkë) përmes kontratës me SH.P.K. BENI-DONA-Prishtinë Nr. Id. 214/12/822/111. Gjatë inspektimit dhe intervistimit të zyrtarëve të NJSI-së, inspektorët u informuan për brengën e këtij stafi, se ushqimi i përgatitur nga kjo kompani nuk është i pastër dhe i kualitetit/kalorive të nevojshme për NJSI. Gjatë inspektimit të menzes në kohën e servimit të ushqimit, menya ishte e përgaditur për një javë dhe në ditën e inspektimit ushqimi ishte në përrputhje me menynë e paraparë.

3.4.8. Vlen të ceket se gjendja është duke u përmirësuar nga momenti kur zyrtarët e NJSI-së ishin ankuar në ushqimin që u servohet e posaqerisht nga momenti kur është kryer ekzaminimi mjekësor i operatorëve të njësisë, ekzaminimi i kryer për përgatitje të njësisë për testim. Nga ky ekzaminim, sipas operatorëve të NJSI, nga 42 operator të ekzaminuar mbi 30 operator janë me bakte *Helicobakter Pylori*.

3.4.9. Bazuar në informatën e marr nga zyrtarët e NJSI-së se NJSI është vizituar nga DSHSH/DPP. Inspektorët e IPK-së kanë vizituar DSHSH/DPP, nga kjo drejtori kanë marrë informata në lidhje me inspektimin e Kampit “Vrella”, dhe nga dokumentacioni i prezantuar, mësuan se DSHSH/DPP në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHPK) kanë vizituar Kampin “Vrella” me qëllim vlerësimi të Standardeve të Higjienës. Sipas Konkluzionit të raportit të IKSHPK-së, Standardet e Higjienës paraqesin rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e të punësuarve në Kampin “Vrella”<sup>14</sup>. Sipas drejtoreshës së DSHSH/DPP, burim i infeksionit: 1) Ushqimi dhe uji i pa kontrolluar; dhe 2) Përqindja e infektimit është thellësisht në funksion të kushteve të higjienës.

<sup>14</sup> Konkluzion i KSHPK-së dërguar më postë elektronike nga DSHSH/DPP, Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së (Sent: Wed. 5/29/2013 10:49 AM);



3.4.10. Sipas dokumentacionit të prezantuar nga DSHSH/DPP, 25 pjesëtar nga numri total 40 i pjesëtarëve të NJSI-së, të ekzaminuar janë të diagnostifikuar me *Helicobakter Pylori* pozitiv/aktiv dhe shumica me *Pëngesat Gastroenterologjike*<sup>15</sup>. Përkundër Diagnostifikimit të pjesëtarëve të NJSI, sipas rekomandimit të DSHSH/DPP këta pjesëtar të NJSI-së janë të aftë për punë në këtë njësi por ata duhet kryer terapitë përcjellëse.

3.4.11. IKSHPK, ka hartuar raport nga inspektimi i datës 27 dhe 28 maj 2013 dhe ka dalë me këto rekomandime për Kampin "Vrella": 1) Blerja e makinës për larjen e enëve dhe një dollapi të mbyllur ku ruhen enët e pastëra; 2) Grumbullimi i mbeturinave të ushqimit të bëhet në këndin kah dera e trapezarisë dhe jo në pjesën ku distribuohet ushqimi; 3) Frigoriferi të pastrohet rregullisht dhe të përdoret vetëm për artikujt që kërkojnë temperaturë frigoriferi; 4) Ushqimet që vendosen në Frigorifer duhet të jenë pa ambalazh (qese plastike, paketa, kutia e të ngjashme; 5) Blloku sanitar kërkon disa riparime: Izolimi i gypave të kanalizimit, funksionalizimi i dush kabinave, rregullimi i krojeve të prishura në hapësirat para WC, rregullimin e ujëshpërlarsëve në WC, vendosja e guacave për urinim në nyjet sanitare për meshkuj; 6) Mirëmbajtjen e rregullt të tyre , furnizimin e rregullt me sapun të lëngshëm dhe letër tualeti<sup>16</sup>.

#### **Rekomandimi nr. 7**

IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara të i zbatojë në praktikë rekomandimet e IKSHPK në Kampin "Vrella" me qëllim të ruajtje së shëndetit të pjesëtarëve të NJS të vendosura në këtë kamp.

3.4.12. Breng në veti për operatorët e NJSI është edhe udhëtimi nga baza në shtëpi dhe anasjelltas pas përfundimit të orarit të punës apo operacionit. Në bazë të një urdhërese nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse i PK-së, kërkohet që të ulën shpenzimet në derivate deri në nivelin 40%. Në bazë të kësaj urdhërese kërkohet nga drejtoret, komandantët e njësive dhe vartësit e tyre që të shtohet menaxhimi, kontrolli dhe mbikëqyrja në të gjitha nivelet mbi shfrytëzimin e veturave zyrtare me qëllim të minimizimit të shpenzimeve të derivateve<sup>17</sup>. Duke vepruar në bazë të kësaj urdhërese në NJSI janë zvogëluar numri i veturave në thirrje dhe është marrë vendim që këto vetura të parkohen në parkingjet e Drejtorive Rajonale të PK-së.

3.4.13. NSI ka një numër të personelit prej 41 zyrtar policore të uniformuar dhe 1 staf civil. Operatorët e kësaj njësie vijnë nga të gjitha rajonet e Kosovës. Duke vepruar sipas urdhëresës së sipër përmendur NJSI, nga 12 vetura të lëshuara në thirrje sa kanë qenë më parë kanë reduktuar në 8 vetura për operator plus një veturë për Komandantin e NJSI-së. Sipas menaxhereve të NJSI-së kjo ka ndikuar në uljen e shpenzimeve të derivateve në menyrë të dukshme. Mirëpo operatorët e NJSI-së kërkojnë rritjen e numrit të veturave në thirrje me arsyetimin se kjo ndikon në gatishmërinë e tyre për tu përgjigjur thirrjeve për raste, sigurisë së tyre, pasi që janë të detyruar të udhëtojnë me transport publikë apo pritje të veturës në thirrje në vende publike. Sipas operatorëve, 8 vetura në thirrje për operatorët janë pak, dhe për tu mbuluar ky problem kërkojnë që numri i veturave në thirrje të jetë 12.

<sup>15</sup> Raporti dërguar më postë elektronike nga DSHSH/DPP, Drejtorit të Pergjithshëm të PK-së ( Sent: Wed. 5/29/2013 10:49 AM);

<sup>16</sup> Rekomandimet e IKSHPK/Nr. Ref. 07/1-03/886/2013;

<sup>17</sup> Urdhëresa për zvogëlimin e shpenzimeve në derivate 40% /04-02-OPS-094-2013/2013-07-01 3:21 MD;

3.4.14. Duke pasur parasysh rendësinë e NJSI-së për kryerjen e operacioneve të sigurisë në raste të veçanta dhe zgjidhjen e situatave të cilat nuk mund të përballohen me shërbimet e tjera të PK-së, NJSI si njësi elite e PK-së, posaçërisht e trajnuar, e përgatitur dhe e pajisur me pajisje, uniformë përkatëse të veçantë, mjete dhe armë speciale, ku pjesëtarëve të NJSI-së u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale. IPK, nxitë politikat që çojnë drejt menaxhimit, kontrollit dhe mbikqyrjes për zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore por në anën tjetër menaxhmenti i PK-së duhet t'iu dalë në përkrahje racionale/arsyeshme sa i përket transportit të operatorëve të kësaj njësie nga të gjitha rajonet, kur kihet parasysh niveli i rrezikshmërisë që bartin me vete pjestaret e sajë.

3.4.15. Siguri në Kampin "Vrella", në bazë të inspektimit nga inspektorët e IPK-së vlerësohet të jetë e nivelit jo të kënaqshëm, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm prapa kampit, objekti i bazës së NJS-së nuk posedon shkallë emergjente si dhe kjo drejtori nuk ka plan për evakuim për raste emrgjente nga kjo bazë policore. Kampi dhe hapësira e tij sigurohet 24 orë nga 6 zyrtarë të pajisur me armë brezi dhe të gjata, të Drejtorisë për Sigurimin e Objekteve. Hapësira ku është vendosur kampi përfshinë një territor të madh, dhe rrethojat rreth perimetrit të bazës janë të dëmtuara në disa vende. Shqetësimin lidhur me këtë gjendje kishin ngritur edhe vetë menaxheret e Njësive Speciale ku kishin percjellë brengat e tyre në zingjirin komandues.<sup>18</sup>

#### **Rekomandimi nr. 8**

IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse në kuadër të PK-së të marrin masat e nevojshme për ngritjen dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë në Kampin "Vrella", pasi që ky kamp me njësitë e vendosura aty është i një rëndësi vitale për vendin.

<sup>18</sup> FW: Kërkesë/shqetësim për sigurinë në Kampin VRELLA **From:** Amir Gerguri **Sent:** Monday, September 03, 2012 12:08 PM **To:** Arbnesht Ajvazi



## 4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 4.1 Përfundimet

4.1.1 Policia e Kosovës ka Strukturën Organizative të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm e Policisë së Kosovës më datë 20/05/2012. Sipas kësaj kësajë strukture NJSI administrativisht bie në vijë të drejtpërdrejt me Drejtorinë e Njësive të Specializuara. Në bazë të strukturës numri i personelit të NJSI është 51 staf i uniformuar plus 2 staf civil gjithësejtë 53 zyrtar. NJSI është e organizuar në tri ekipe taktike plus një ekip GAKS. NJSI në bazë të strukturës në fjalë udhëhiqet nga zyrtari policor me gradën e kapitenit, ndërsa shefi i operativës të ketë gradën Togerit. Tri ekipet operative numërojnë nga 12 operator si dhe grupi GAKS-it 8 operator, katër ekipet udhëhiqen nga 4 zyrtar policor me gradën e rreshterit, 1 zyrtar policor për resurse dhe 2 staf civil.

4.1.2 NJSI fushëveprimin e aktiviteteve policore e ka të rregulluar me Ligjin e Policisë së Kosovës Nr.04/L-076, Doracaku i Parimeve dhe Procedurave, Procedurat Standarde Operuese NJSI/PSO/001/11 dhe Planin e Standardizuar të Trajnimeve për Njësi Speciale, i aprovuar nga Drejtori i Njësive Speciale.

4.1.3. Struktura Organizative e datës 20/05/2012 e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, nuk është funksionalizuar edhe pse është një vit nga aprovimi i kësaj strukture, NJSI nuk ka diçka të shkruar për sa kohë duhet të jetë e gatshme për reagim gjatë orarit të rregullt të punës dhe kohës kur kjo njësi është në thirrje, NJSI ka zvogëluar numri i veturave në thirrje dhe është marrë vendim që këto vetura të parkohen në parkingjet e Drejtorive Rajonale të PK-së, në trajnimin e organizuar për pjesëtarët e PK-së nga data 03 deri më 28 qershor 2013 në Turqi (në Komandën e Njësitit Special Turk Ozel Harekat), në PK-së ka pasur veprime në kundërshtim me Parimi P-8.16 ( Doracaku i Parimeve dhe i Procedurave), zyrtarët e NJSI nuk janë furnizuar me rroba civile dhe sportive dy apo tri vitet e fundit, Jeleket antiplumb të cilët i shfrytëzojnë operatorët e kësaj njësie tash e një kohë të gjatë kishin afatin e skaduar të përdorimit, mirëmbajtja e banjave dhe tush kabinave nuk është e mirë, furnizimi dhe pastërtia e çarçafëve dhe batanijeve në dhomat e fjetjes që përdorin operatorët nuk është e nivelit të kënaqshëm (vjetrura), siguri në Kampin “Vrella” është e nivelit jo të kënaqshëm, Konkluzioni i Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHPK) se standardet e higjienës paraqesin rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e të punësuarve në Kampin “Vrella”<sup>19</sup>. nuk ka ndriçim të mjaftueshëm prapa kampit, objekti i bazës së NJS-së nuk posedon shkallë emergjente si dhe kjo drejtori nuk ka plan për evakuim për raste emergjente.

4.1.4 Mos funksionalizimi i strukturës, në lidhje me personelin e përgjithshëm, vendosjen e personave me grada nëpër pozita krijimin e ekipet operative, pengesa në organizimin dhe punën e NJSI-së. Mos ekzistimi i një rregulli të shkruar lidhur me parametrat kohorë të reagimit të NJSI, mund të ndikoi efikasitet, vështësi në planifikime operacionale. Zvoglimi i veturave në thirrje për NJSI dhe vendim që këto vetura të parkohen në parkingjet e Drejtorive Rajonale të PK-së ka ndikuar negativisht në kushtet e punës, sigurinë e operatorëve të njësisë dhe motivimin për punë. Anashkalimi i P-8.16 nga U.D. i Drejtorit të Divizionit ka pasur efekte negative NJSI dhe në anen tjetër ky veprim ka treguar një jo seriozitetit nga ana e PK-së karshi donatorit të këtij trajnimi, Njësitit Special Turk (Ozel Harekat). Mos furnizimi i zyrtarëve të NJSI me rroba civile, sportive dhe Jelekë antiplumb me afat shfrytëzimi mund të ndikoi negativisht në shëndetin dhe sigurinë e operatorëve gjatë aktiviteteve të njësisë. Banjat,

<sup>19</sup> Konkluzion i KSHPK-së dërguar më postë elektronike nga DSHSH/DPP, Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së (Sent: Wed. 5/29/2013 10:49 AM);

tush kabinat të vjetruara dhe mos furnizimit me çerçafëve dhe batanijeve në dhomat e fjetjes që përdorin operatorët ndikon negativisht në kushtet higjenike dhe shëndetin e zyrtarëve të njësisë. Mos mirëmbajtja e higjienës në harmoni me standardet paraqesin rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e të punësuarve në Kampin “Vrella” dhe performancën e NJSI. Siguria jo e kënaqshëm në Kampin “Vrella” ndikon negativisht në sigurinë e zyrtarëve, objektit, dhe pajisjeve.

4.1.5. Me qëllim të ngritjes së performancës së njësisë menaxhmenti kompetent brenda kompetentecave dhe autorizimeve të ndërmarr hapa dhe veprime: të implementoi Strukturën Organizative të datës 20/05/2012 për NJSI, të nxjerrë në formë të shkruar parametrat që përcaktojnë kohën e shpejtësisë së mobilizimit dhe reagimit të kësaj njësie në përgjigje të rasteve dhe operacioneve policore, t’iu dalë në përkrahje operatorëve të NJSI-së të gjitha rajoneve nga vijnë në lidhje me transportin, të aplikoj me përpikëri të plotë P-8.16, të veprojnë në përputhje me pikën 10 të PSO së NJSI, që ka të bëjë me furnizimin me rroba civile dhe sportive, të i zbatojë në praktikë rekomandimet e IKSHPK në Kampin “Vrella”, të marrin masat e nevojshme për ngritjen dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë në Kampin “Vrella”.

## 4.2 Rekomandimet:

1. IPK-ja, Rekomandon, Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, implementimin e Strukturës Organizative të datës 20/05/2012, e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, në lidhje me personelin e përgjithshëm, vendosjen e personave me grada nëpër pozita në harmoni me strukturës në NJSI-në.
2. IPK-ja, rekomandon: komandanti dhe operatorët e NJSI, të angazhohen më tepër me qëllim të ngritjes së përqindjes së realizueshmërisë të planit për aktiviteteve trajnuese në NJSI, për ngritjen e performancës dhe gatishmerise së kësaj njësie.
3. IPK-ja rekomandon: Komandantit të njësisë që në bazë të analizimit të faktorëve dhe testimit të nxjerrë në formë të shkruar parametrat që përcaktojnë kohën e shpejtësisë së mobilizimit dhe reagimit të kësaj njësie në përgjigje të rasteve dhe operacioneve policore duke e konsideruer seriozisht që kjo njësi të jetë në detyrë 24 orë, pra të punojë në tre ndrrime.
4. IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të DNJS të PK-së t'iu dalë në përkrahje operatorëve të NJSI-së të gjitha rajoneve nga vijnë në lidhje me transportin, të shtohet numri i veturave në thirrje me qëllim të ngritjes së performancës, sigurisë, motivimit në NJSI.
5. IPK-ja, rekomandon: U.D Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, në të ardhmën të veprimi në bazë të kërkesës së Departamentit të Trajnimeve dhe të aplikoj me përpikëri të plotë P-8.16. Listen e nominuar të zyrtarëve policor për trajnim jashtë vendi DNJS ta dërgoi te Departamenti i Trajnimeve për procedim të matutjeshëm.
6. IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara që të rivlerësojë lokacionin në të cilin gjendet NJSI duke marrë në konsiderat ruajtjen/fshehjen e identitetit të operatorëve gjatë operacioneve të ndryshme që kryen NJSI, të kujdeset që paisjet që ka në përdorim kjo njësi të jenë e kualitetit më të lartë dhe në gjendjen më të mirë si dhe në përpunime me pikën 10 të PSO së NJSI, të bëjë me furnizimin me rroba civile dhe sportive, me qëllim të ruajtjes së shëndetit gjatë aktiviteteve fizike.
7. IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara të i zbatojë në praktikë rekomandimet e IKSHPK në Kampin "Vrella" me qëllim të ruajtjes së shëndetit të pjesëtarëve të NJS të vendosura në këtë kamp.
8. IPK-ja, rekomandon: Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse në kuadër të PK-së të marrin masat e nevojshme për ngritjen dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë në Kampin "Vrella", pasi që ky kamp me njësitë e vendosura aty është i një rëndësi vitale për vendin.